



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHITES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Nr. i Protokollit: 09/ 107

Shtime, më 26.12. 2024

Duke u bazuar në Rregulloren Npi-01/461 për Procedurat dhe Kriteret për Zgjedhjen e Laureatëve në Sport, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Shtimes, shpall:

K O N K U R S

Për të gjitha Klubet, Shoqatat Sportive dhe Individët, që të dërgojnë propozimet e tyre përmes Klubeve Sportive dhe individëve për kategorinë e caktuar për zgjedhjen e sportistëve më të mirë të vitit.

Propozimet mund të bëhen për:

- Sportist më të suksesshëm – kategorinë senior/e (vendi i I,II dhe III);
- Sportist më të suksesshëm - kategorinë junior/e (vendi i I,II dhe III);
- Sportist më të suksesshëm - kategorinë kadetë/e (vendi i I,II dhe III);
- Skuadren më të suksesshme të femrave;
- Skuadren më të suksesshme të meshkujve;
- Trajnerin më të suksesshëm;
- Trajnerin më i suksesshëm për të rinj;
- Punëtorin sportiv më të suksesshëm;
- Sportistin më të suksesshëm / sportisti me aftësi të kufizuara;
- Klubin sportiv më të suksesshëm në sportet ekipore;
- Klubin sportiv më të suksesshëm në sportet individuale;
- Ekipin më të suksesshëm shkollor;
- Sportistin më të suksesshëm nga komuna e Shtimes që garon për një skuadër tjetër, skuadër të huaj apo shtet të huaj.

1. Të drejtën për të aplikuar si kandidat për shpërblime dhe mirënjohje kanë personat juridik dhe fizik, anëtar të komunitetit sportiv në komunën e Shtimes. Kandidatët patjetër duhet të jenë anëtar të klubeve, të cilat janë të licencuara nga federatat kombëtare dhe të njohura zyrtarisht nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) dhe Departamenti për Sport në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

2. Njihet vetëm rang lista zyrtare në fund të vitit ose sezonit garues të Federatës Kombëtare ose Ndërkombëtare.

3. Në rast të ekzistimit të rangut identik pas zbatimit të kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, Komisioni ka të drejtën ekskluzive të marrë vendim që t'i jap përparësi individit dhe/ose ekipit. Në rast të një arritjeje të rëndësishme sportive, federata e sportit në të cilën kandidati ka arritur rezultatin nuk është në listën zyrtare të federatave kombëtare sportive dhe/ose është në proces të njohjes, Komisioni ka të drejtë të marrë një vendim me përjashtim të atij kandidati.

Gjatë propozimit për laureatë, në mënyrë të qartë duhet të përshkruhet aktiviteti i secilit sportist dhe të specifikohet pjesëmarrja në të gjitha garat ekipore dhe individuale, (Medaljet, Diplomat, Certifikata, Arritjet, etj.), në të cilat ka garuar sportisti, klubi dhe suksesin të cilin e ka arrit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë vitit 2024.

Propozimet duhet të dorëzohen sipas formularit të publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes, në linkun: <https://kk.rks-gov.net/shtime/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/>

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në zarfë të mbyllur, personalisht në Zyrën e DKRS-së ose përmes e-mail adresës: dkrs.shtime@rks-gov.net

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga data **26. 12. 2024**, deri më datë **18. 1. 2025**, ora **16:00**. Zgjedhja e më të mirëve do të vlerësohet nga komisioni i themeluar për këtë qëllim.

